



Datë: 13.10.2025  
Numër Protokolli: 6794/2025

A.nr.884/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.884/2025, të datës 14.05.2025, të parashtuar nga ankuesit L.K-B, A.I dhe B.U, të cilët sipas autorizimit të përbashkët i përfaqëson L.K-B, kundër Vendimit nr.prot:3849/25 të datës 13.05.2025, të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.10.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon Procedimi Adminsitrativ** i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.884/2025, të datës 14.05.2025, të parashtuar nga ankuesit L.K-B, A.I dhe B.U.

## A r s y e t i m

Nëpunësit civilë L.K-B, A.I dhe B.U (*në tekstin e mëtejme referuar: vetëm Ankuesit*), më datë 14.05.2025, kanë parashtuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit nr.prot:3849/25 të datës 13.05.2025, të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritet të Aviacionit Civil.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtuara nga palët në procedurë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.884/2025, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesit janë të punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) dhe atë: ankuesi A.I ushtron pozitën Drejtor i Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, ankuesja L.K-B ushtron pozitën Drejtor i Departamentit për Siguri dhe Cilësi dhe ankuesja B.U ushtron pozitën Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit.

Tutje sipas shkresave të lëndës rrjedhe së Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 13.05.2025 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 3849/2025, me të cilin zyrtarin M.K, në pozitën e Inspektorit të Vlefshmërisë Ajrore, aktualisht ushtrues detyre i Udhëheqësit të Divizionit të Vlefshmërisë Ajrore edhe Licencimit të Personelit, e ka caktuar si ushtrues i detyrës së

Drejtoria të Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, pa specifikim të kohës së ushtrimit të përkohshëm të detyrës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshtojnë ligjshmërinë e Vendimit me numër protokoli 3849/25, të datës 13.05.2025, të Ministrit të MMPHI-së, për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtoria të Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, duke pretenduar se akti i kontestuar është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale dhe materiale, me theks të dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Ligjit për Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ngase, si ushtrues detyre është caktuar një nëpunës që për nga akti i emërimit mbanë pozitë të kategorisë profesionale e duke u anashkaluar nëpunësit e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës që për nga akt emërimi mbajnë pozita të kategorisë së mesme drejtuese. Kërkojnë që ankesa të miratohet në tërësi si e bazuar, të anulohet Vendimi me numër protokoli 3849/25, i datës 13.05.2025, i Ministrit të MMPHI-së, si dhe të detyrohet ministri i MMPHI-së që të emëroja si ushtrues detyre të Drejtoria të Përgjithshme të AAC-së njërin nga zyrtarët me të lartë publikë që mbajnë akt emërim të kategorisë pasuese.

Më datë 10.10.2025, Ministri i MMPHI-së ka nxjerrë Vendimin me nr.prpt:9523, më të cilin ka shfuqizuar Vendimin më nr.prot:3849/25 të datës 13.05.2025, duke caktuar ankuesin A.I në pozitën e ushtruesit të detyrës së Drejtoria të Përgjithshme të AAC-së.

Andaj, marrë parasysh faktin se objekti i kontestit është kundërshtimi i ligjshmërisë së vendimit më nr.prot: 3849/25 të datës 13.05.2025 dhe meqenëse palët në petitumin e ankesës kërkojnë anulimin e këtij akti si dhe emërimin e ushtruesit të detyrës së Drejtoria të Përgjithshme të AAC-së nga zyrtarët e kategorisë pasuese, atëherë, me nxjerrjen e Vendimit nr.prot:9523/20255 të datës 10.10.2025 të ministrit të MMHI-së, objekti i ankesës është bërë i pamundur, sepse përmes këtij akti është arritur qëllimi i palës ankesës si në ankesë, rrejdhimisht është anuluar akti i kontestuar dhe si ushtrues detyre i Drejtoria të Përgjithshme të AAC-së është caktuar ankuesi A.I, që i njëjti sipas aktit të emërimit mbanë pozitën e drejtoria si kategori e nivelit të mesme drejtues gjegjësisht si kategori pasuese pas pozitës së drejtoria të përgjithshme, kështu që, mbi këto rrethana e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.884/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Përmbledhur si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër A.nr.884/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

---

*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

---

*Kryetare e Kolegjit*

### **Vendimi i dorëzohet:**

- Pëfaqësueses së ankuesve znj. L.K-B;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.